



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:257813
Datë: 08.12.2023
Numri i dokumentit: 05034247

C-IV-14-5988

Ankuesi

B D fshati P, Prishtinë.

Kundër

Pala kundërshtare

N.SH “Germia” në likuidim, përfaqësuar nga
Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakërishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 08 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Vendimi e Agjencisë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, Nr. PRN093-1020 i datës 20 gusht 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- 3. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 25 tetor 2007, ankuesi ka parashtruar një kërkesë pranë Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me te cilën ka kërkuar kompensimin e mjeteve të asistencës sociale, nga N.Sh “Germia” (në Likuidim).

Autoriteti i Likuidimit me Vendimin nr. PRN093-1020 të datës 20 gusht 2014, kërkesën e parashtruesit e ka refuzuar si të pavlefshme.

Me 28 gusht 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (tutje shkurtesa DHPGJS), kundër Vendimit nr. PRN093-1020 të datës 20 gusht 2014, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuara të dispozitave të Ligjit për AKP-në. Ankuesi në ankesë ka pohuar se në N.SH është lajmëruar në punë por pa fajin e tij ai është caktuar në asistencë sociale dhe mjetet për këtë pagesë janë siguruar nga qiraja e lokaleve të NSh-së. Ankuesi ka kërkuar që atij ti kompensohet shuma e papaguar prej 1,500 € (pra nga 50 € në muaj) dhe at nga 01 janar 2005 deri me 14 gusht 2007. I ka propozuar Gjykatës që ankesën tij ta aprovoj si të bazuar. Ankuesi si provë ka bashkangjitur vendimin e kundërshtuar formularin e kërkesë të cilën e ka paraqitur tek AL dt. 25 tetor 2007 dhe vendimin e përkohshëm mbi vazhdimin e asistencës sociale nr. 470 dt.04 qershor 2001.

Me 16 mars 2017, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura po ashtu e ka kundërshtuar edhe ekzistencën e detyrimit po ashtu edhe lartësinë në fakte dhe prova të besueshme duke ju referuar rregullit bazik në procedurën civile kontestimore, përkatësisht nenit 7 dhe nenit 23 të shtojcës së ligjit të Dhomës së Posaçme. Tutje AKP-ja thekson se vendimi i AL-së është i drejtë, edhe për faktin se parashtruesi nuk kishte dorëzuar dëshmi të mjaftueshme dhe se edhe pas kërkesës së AL-së me 02 maj 2014 për dëshmi dhe informacion shtesë përkatësisht kopjen e vendimit mbi asistencë sociale të lëshuar nga N.Sh-ja për periudhën janar 2005 deri gusht 2007, por parashtruesi nuk është përgjigjur me dëshmitë konkrete të kërkuara. I ka propozuar Gjykatës që ankesën e ankuesit ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL.

Ankuesi në përgjigje ndaja mbrojtës së AKP-së ka theksuar se ai ka punuar në NSH prej para luftës deri në vitin 1991 kur janë ven masat e dhunshme në ndërmarrje dhe punëtorët janë larguar nga puna. Ankuesi përsërit edhe një here se N.SH i ka mbetur i papaguar kompensimi i mjeteve të asistencës sociale në shumë prej 1,500 € (pra nga 50 € në muaj) dhe at nga 01 janar 2005 deri me 14 gusht 2007.

Me 05 maj 2017, e padatuar ka parashtruar kundërpërgjigje duke e theksuar se ankuesi për periudhën të cilën i kërkon kompensimin e papaguar nuk ka qenë në punë për shkak se N.Sh nuk ka zhvilluar aktivitet ekonomik dhe gjithashtu shton se lista të cilën i referohet ankuesi në mbrojtje është një listë e punëtorëve që kanë përfituar asistencë sociale deri me 31 dhjetor 2005 pra për 11 muaj dhe se kjo listë nuk vërteton se ndonjë borxh që N.SH-ja ka ndaj parashtruesit. I ka propozuar gjykatës që në mungesë të provave të refuzoj ankesën e ankuesit.

Për detaje të tjera referimi bëhet në shkresat e lëndës.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të Nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, lidhur me Nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Autoriteti i Likuidimit kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të N.Sh-së, ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të N.Sh “Germia” (në likuidim), se afati për parashtrimin e kërkesave ishte deri me datën 25 tetor 2007. Ankuesi e kishte dorëzuar kërkesën e tij te Autoriteti i Likuidimit brenda afatit të përcaktua për parashtrimin e kërkesave kreditore me 25 tetor 2007.

Sipas gjykatës nuk është kontestues se AKP përmes shkresës së datës 18 korrik 2014, kishte kërkuara nga ankuesi që të dorëzoj dokumente shtesë në mbështetje të kërkesës, konkretisht vendimin mbi asistencën sociale të lëshuar nga menaxhmenti i N.Sh “Germia” për periudhën janar 2005 deri në gusht 2007. Gjykata vëren se ankuesi i ishte përgjigjur, por ai nuk kishte dorëzuar vendimin e kërkuar, por kishte dorëzuar vendimin e përkohshëm për asistencë sociale dt.02.04.2001.

Gjykata vëren se AL me rastin e shqyrtimit të kërkesë së ankuesit drejtë kishte aplikuar drejtën material dhe procedurale. Ankuesi kërkesën e tij tek AL e kishte paraqitur si jo të plotë pa mbështetje me prova. Pas kësaj AL me të drejtë e kishte aplikuar nenin 23.3 të Shtojcës së ligjit nr.04/L-034, ku kishte kërkuar nga ankuesi dokumente dhe dëshmi që do ta mbështetnin pretendimin e tij në cilësinë e kreditorit.

Nenin 36 par 2, nën-paragrafi 2. 2 i të njëjtit Ligj, parasheh që dokumentacioni për kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese, përbenë një bazë të mirë dhe të mjaftueshme për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar.

Po ashtu gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtorë i N.SH-së dhe se është larguara nga puna në vitin 1991, të cilin fakt e ka pohuara vet ankuesi me ankesë. Por kontestues ka qenë fakti nëse N.SH “Gërima” a i ka mbetur borxh ankuesit shumen e papaguar prej 1,500 € që kishte të bënte me pagesën e asistencës sociale.

Neni 42, paragrafi 2, i Ligjit për Dhomën se Posaçme (Ligji nr.06/L-086), para sheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të

tillë, duke paraqitur parashtrësata apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa paragrafi 3 i këtij neni, parashihet se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, dhe nëse pala dështon që të paraqes prova të tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Gjykata nga shkresat e lëndës vjen në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi relevante që dëshmon se N.SH “Gërmia” i ka mbetur borxh apo siç theksohet në vendimin e AL shumen e papaguar që kishte të bënte me asistencën sociale. Ankuesi, ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të kërkesë se tij si para AL ashtu edhe në gjykatë. Kopja e vendimit mbi vazhdimin e asistencës sociale nr. 470 dt.04 qershor 2001, nuk është dëshmi për borxhin e pretenduar por është vendim i përkohshëm lidhur me drejtën në gëzimin të asistencës sociale dhe që i përket periudhës së caktuar. Edhe lista e kopjes së punëtorëve që kanë përfituar asistencë sociale për periudhën 1 vjeçare, për vitin 2005, përfshin vetëm periudhën 1 vjeçare dhe nuk përfshin periudhën për vitin 2006 e deri në gusht të vitit 2007. Aq më tepër kur në këtë listë nuk figuron as emri i ankuesit, prandaj pretendimet e ankuesit në këtë aspekt janë të pabazuara.

Gjykata konsideron se ka vlerësuar të gjitha pretendimet relevante të palëve në lidhje me objektin e kontestit. Nuk ka pretendime të tjera të cilat mund të ndikojnë për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar